



---

## Asociacioni i Komunave të Kosovës

### RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet

**Prishtinë, 23 gusht 2011**

---

**Për:** Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

**Nga:** Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

**Lënda:** Raport nga takimi i Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet



## **HYRJE**

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet organizoi takimin e tretë të këtij Kolegjiumi për këtë vit me 23 gusht 2011 (e martë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin 'Villa Gërmia' në Prishtinë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Ndarja e granteve qeveritare dhe investimet kapitale,
- Dorëzimi i buxhetit,
- Harmonizimi i rregulloreve komunale,
- Decentralizimi fiskal (arsim, mirëqenie sociale, regjistrimi i bizneseve)
  - 5 punëtorë rajonale për shërbimet sociale në shtator
  - 1 punëtorë kolegji për rini në nëntor

Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Financa dhe Buxhet nga Komunitet e Kosovës. Po ashtu ishin prezent edhe znj. Kimete Zekaj, analiste e buxhetit komunal në Ministrinë e Financave, Mentor Rexhepi nga LOGOS-i, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesja e Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet, znj. Afërdita Grapci.

## **PËRMBLEDHJE**

Kryesuesja në hapjen e takimit shpreh edhe një herë brengën e saj rreth pjesëmarrjes së dobët të anëtarëve në takimet e Kolegjiumit si dhe angazhimit të tyre në proceset të cilat lidhen me fushën e buxhetit dhe financave me interes për komunitet. Nga pjesëmarrësit u shtua se duhet të ketë një trysni më të madhe për prezencë më aktive si dhe një angazhim më serioz të Drejtorëve në takimet e Kolegjiumit, sepse nga takimet e Kolegjiumit duhet të dalim me kërkesat dhe qëndrimet e përbashkëta në mbrojtje të interesave komunale karshi kërkesave të Ministrisë së Financave.

Të pranishmit informuan se komunitet janë duke iu përmbajtur procedurave dhe kufijve buxhetorë për planifikim ashtu si është paraparë në Qarkoren buxhetore për vitin 2012. Megjithatë mbetet pikëpyetje se si funksionon procesi i planifikimit dhe sa a krijon pengesa Qarkorja buxhetore për komunitet?

Komunitet kanë mbajtur dëgjimet publike, mirëpo pjesëmarrja është e ulët, me përjashtim të komunave të cilat janë ndihmuar nga LOGOS.

Granti specifik për arsim është zvogëluar në masë të madhe në nivel të Kosovës. Kjo do të sjell pasoja shumë serioze në menaxhimin e institucioneve shkollore komunale sepse këto mjete janë të pamjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat dhe obligimet. P.sh. derisa me kufij buxhetorë janë përcaktuar 23 euro/nxënës, 21 euro harxhohen vetëm për nxehje ndërsa 2 euro të mbetura janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet tjera për menaxhim të shkollave. Në këtë rast komunitet obligohen që të mbulojnë deficitin nga granti i përgjithshëm.

Investimet kapitale për këtë vit janë zvogëluar, por është rritur buxheti për mallra dhe shërbime për mirëmbajtje të investimeve. Me gjithë këtë, mjetet për mirëmbajtje janë të pamjaftueshme, sidomos

kur merren parasysh investimet e bëra nga donatorët në objekte moderne e të cilat kërkojnë mjete të mëdha për mirëmbajtje.

Komunat po ashtu hasin probleme edhe sa i përket pagave dhe mëditjeve për punën shtesë të stafit komunal (administrata e cila i shërben mërgimtarëve, inspektorëve, tregu i qytetit, etj). Meqë kompensimi bëhet me ditë të lira e jo me mjete financiare (sipas një shkrese të Ministrisë së Financave), motivimi i stafit mund të bie e që mund të reflektohet edhe në efektshmërinë e komunave.

Komunat po ashtu kanë pengesë në ngritjen apo uljen e koeficienteve të stafit sepse MAP-i nuk aprovon asnjë kërkesë të tillë me arsyetimin se kanë urdhër të prerë nga MF të mos bëjnë ndryshim të koeficienteve pa miratimin paraprak të MF-së. Në anën tjetër përfaqësuesja e MF-së që ishte prezent në takim insiston se kjo nuk qëndron, dhe se kjo ndalesë bëhet nga MAP-i. Kjo ndërlidhet edhe me një problem tjetër lidhur me MF – sa herë që komunat kërkojnë ndonjë sqarim, punonjësit e MF-së ofrojnë përgjigje jo-koherente dhe atë vetëm gojarisht e jo me shkrim. Kjo lë komunat në pozitë të vështirë për të vendosur se cila përgjigje është e drejtë, dhe në anën tjetër nuk kanë mbulesë me shkrim për një vendim të tillë.

Për më tepër, ka komuna që janë në deficit për paga dhe mëditje deri në 800,000€ e në disa raste punëtorët kanë mbetur pa paga – e gjithë kjo për arsye të keq-kalkulimeve nga MF në alokimin e mjeteve të komunave për ngritje të pagave.

Vlerësimi i të gjitha komunave është se MF duhet ta rishikojë edhe njëherë ndarjen e granteve specifike për arsim, por edhe për shëndetësi sepse gjendja ekzistuese është duke shkaktuar probleme të mëdha dhe me pasoja serioze në komuna.

Drejtorët shprehën shqetësimin e tyre për atë se edhe pse shumë herë është diskutuar dhe kanë marrë zotime nga ana e qeverisë për liberalizim të planifikimit buxhetor, realiteti po tregon qasjen drejt një centralizimi dhe kontrolli të plotë financiar nga ana e Qeverisë. Niveli qendror ka fleksibilitet shumë më të madh se komunat edhe në planifikim por edhe në caktimin e koeficienteve. Kjo shihet nga punëtorët të cilët me delegim të kompetencave vijnë në komuna.

Nga përfaqësuesit e AKK-së u paraqitën edhe kërkesat për sqarim të cilat kanë dalë nga takimet e rregullta me Bordin e AKK-së ku janë evidentuar këto vërejtje:

- çdo të bëhet me mjetet e planifikuar dhe të pashpenzuara - e do të mundën të ri-destinohen?
- përkundër tendencave të MPB-së që të hiqen kushtëzimet me tatim në pronë për regjistrim të veturave, AKK-ja ka arritur të ndalojë një gjë të tillë duke marrë parasysh se kjo do të zvogëlonte në një masë të madhe të hyrat komunale nga tatimi në pronë .
- projektligji për paga të funksionarëve publik është në shqyrtim dhe po diskutohet në grupin e brendshëm punues qeveritar ku AKK do të paraqes qëndrimin e vet sapa të ftohet.
- AKK vite më parë ka rekomanduar që çdo komunë të ketë 60 shërbyesve civil + 1 punëtorë për çdo 1000 banorë. Mirëpo kjo nuk është përfillur deri tani nga Qeveria.

- Qeveria planifikon të ulë grantet qeveritare dhe të ngriten të hyrat vetanake të komunave përmes rritjes së normës së tatimit në pronë. Nëse kjo ndodh, përçindja e inkasimit të hyrave nga tatimi në pronë mund të bie.

Sa i përket harmonizimit të rregulloreve, Kolegjiumi ishte kategorik se certifikimi i rregulloreve nuk mund të bëhet nga MF, sepse rregulloret komunale janë kompetencë kryekëput e Kuvendeve Komunale.

Po ashtu u informua se MTI ka themeluar një grup punues i cili është duke shqyrtuar mundësitë për lehtësimin e regjistrimit të bizneseve (kryesisht ato individuale), duke hequr lejet e punës si dhe taksat dhe ngarkesat të cilat i sigurojnë komunave të hyra vetanake. U pajtua që Kryesuesja e këtij Kolegjiumi të merr pjesë në këtë grup punues së bashku me stafin e AKK-së. Materialet do t'u dërgohen Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa si dhe Kolegjiumit për Ekonomi dhe Zhvillim për të dhënë komentet e tyre. Kolegjiumet do të duhet të përgjigjeshin mundësisht para 26 gushtit, në mënyrë që ato komente të diskutohen në takimin e Bordit të AKK-së me 26/08/2011.

Në fund AKK paraqiti disa aktivitete që janë duke u planifikuar si:

- Do të mbahen pesë punëtori rajonale për shërbime sociale prej 19-23 shtator, ku do të ftohen edhe drejtorët komunal për buxhet dhe financa
- Në tetor do të ketë një vizitë në Shqipëri për të diskutuar rreth decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale, e cila përkrahët nga DFID
- LOGOS ka ndihmuar 9 komuna në evidentimin e objekteve të paregjistruara, për inkasim të tatimit në pronë. Këtë përvojë LOGOS do të shkëmben me të gjitha komunat përmes takimeve të ardhshme të Kolegjiumit
- AKK me ndihmën e GIZ-it në nëntor do të organizoj një punëtori për Kolegjiumin së bashku me zyrtarët komunal për rini, ku do të shqyrtohen mundësitë për financim të qëndrueshëm të aktiviteteve rinore në komuna

## **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

1. Të caktohet një takim mes AKK-së, Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa dhe Ministrit Bedri Hamza për të diskutuar rreth bashkëpunimit më të ngushtë mes komunave dhe MF-së. Kryesuesja ka kërkuar një takim të tillë dhe presim përgjigje nga Ministri. Temat për diskutim janë:
  - a. Ndarja e granteve qeveritare (sidomos për arsim dhe shëndetësi)
  - b. Decentralizim i përgatitjes dhe ekzekutimit të buxhetit
  - c. Pagesa e stafit komunal për punë shtesë
  - d. Ri-destinimi i mjetet e të pashpenzuara
  - e. Projektligji për paga të funksionarëve publik
2. Certifikimi i rregulloreve komunale nuk mund të bëhet nga MF, sepse kjo është kompetencë e Kuvendeve Komunale
3. Kryesuesja e Kolegjiumit së bashku me stafin e AKK-së të marrin pjesë në grupin punues të MTI-së për lehtësimin e bizneseve. Kolegjiumi të dërgoj komentet në këtë temë jo më larg se 26 gusht 2011
4. AKK të njoftoj Kolegjiumin me kohë për të gjitha aktivitetet e ardhshme